



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE
Kërkime politike 2010/8

FORCIMI I SUNDIMIT TË LIGJIT NË KOSOVË: LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Prishtinë, nëntor 2010

www.kipred.net

Ky botim është realizuar me përkrahjen e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e KIPRED dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KCSF-së.

Përgatitur nga: Ariana Qosaj-Mustafa

Me kontributin e: Krenar Gashit dhe Adem Gashit

Copyright © 2010 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruer, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Luteni të kontaktoni: info@kipred.net apo +381 38 227 778.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Rruga "Rexhep Mala", Nr 5A
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel dhe Fax: +381 38 227 778
www.kipred.net

PËRMBAJTJA

I. Hyrje.....	5
Metodologjia	6
II. Prapavijë e shkurtër	7
III. Pasqyra Institucionale.....	8
a) Institucionet e Kosovës.....	11
b) Shërbimet Gjyqësore dhe Prokuroriale	12
c) Përkrahja e EULEX.....	16
d) Shërbimet gjyqësore.....	17
e) Kapacitetet e policisë	19
IV. Gjendja e korrupsionit dhe krimit të organizuar	21
V. Zhvillimet e fundme në luftën Kundër Korrupsionit	22
a) Konfiskimi i dobive pasurore të fituara nga aktivitetet penale	26
VI. Lufta Kundër Krimit të Organizuar	27
VII. Të gjeturat kryesore	30
VIII. Rekomandime.....	34

LISTA E SHKURTESAVE

KE	Komisioni Evropian
ESDP	Politika për Siguri dhe Mbrojtje Evropiane
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë
PSBE	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
ICO	Zyra ndërkombëtare civile
KPGjP	Këshilli i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial
ISG	Grupi Drejtues Ndërkombëtar
AKK	Agjencia Kosovare Kundër Korrupsion
KIPRED	Instituti Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillime Politikash
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MMK	Monitorim Mentorim Këshillim
MeD	Ministria e Drejtësisë
MTPT	Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PVPT	Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit në Prishtinë
PSK	Prokuroria Speciale e Kosovës
Task Force	Task-Forca Anti-Korrupsion
THB	Trafikimi i Qenieve Njerëzore
TIP	Trafikimi i Personave
UNMIK	Misioni Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNSCR	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

I. HYRJE

Që nga shpallja e pavarësisë së saj në 2008, Kosova ka kaluar nëpër një numër procesesh të shtet-ndërtimit. Sa i përket përforcimit të mundësive dhe legjitimitetit përballë qytetarëve të vet, ka dështuar t'i përmbushë pritjet shoqërore, në veçanti në garantimin e qeverisjes së sundimit të ligjit. Shtetet e brishta janë të ballafaquara me zhvillim të dobët, investime të ulëta ekonomike dhe përballen me vështirësi në performancën e tyre demokratike. Për të ndërtuar një shtet të qëndrueshëm për qytetarët e vet, shtetet duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme të kontrollit dhe vlerësimit për të matur nivelin e performancës së tyre.¹ Për këtë arsye, KIPRED ka analizuar reagimin aktual të Kosovës ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, me qëllim të përkrahjes së procesit të ndërtimit të një shteti të qëndrueshëm për qytetarët.

Administrata e kaluar e Kombeve të Bashkuara (UNMIK) dështoi që tu ofrojë qytetarëve të Kosovës një administratë e cila do të kishte prioritet respektimin e sundimit të ligjit. Në Kosovën e pas-pavarësisë shoqëria civile, mediat dhe akterët e komunitetit ndërkombëtar gjithnjë e më shumë i bëjnë thirrje Kosovës që të përmirësojë performancën e vet në sundim të ligjit në mënyrë që të rrisë mundësitë dhe legjitimitetin e vet. Pritjet shoqërore kanë pësuar ngritje veçanërisht me zhvillimet e fundme në hetimet e krimit të organizuar dhe korrupsionit në Kosovë. Rritja e pritjeve ka ardhë si pasojë e gati 10 viteve të ngurrimit të UNMIK-ut të hetojë dhe luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin, gjë që ka çuar në mosndëshkimin e kriminelëve. OKB-ja e arsyetoi dështimin e sajë për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin si pasojë e presionit të vendeve të huaja të fuqishme për të ruajtur 'paqen dhe stabilitetin' në Kosovë.² Pos kësaj, hetimet e nisura rishtazi nga Misioni i Sundimit të Ligjit në Kosovë, EULEX, dhe deklarimi i tyre për ndjekjen e "peshqve të mëdhenj" ngritën edhe më shumë pritjet dhe përkrahjen shoqërore për veprimet e tyre.³ Këto aksione po ashtu nisën debate lidhur me vullnetin dhe kapacitetet e këtij misioni dhe të autoriteteve kosovare që

¹ Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD DAC), *State Building in Situations of Fragility*, Gusht 2008.

² Shih intervistën e ish-Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të UNMIK, Z. Soren Jessen Petersen nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtues "Më ndaluan të hulumtoja korrupsionin" në <http://www.balkaninsight.com/en/article/jessen-petersen-i-was-stopped-from-investigating-corruption>.

³ Shih për shembull peticionin në përkrahje të punës së Ushtruesit të detyrës Prokurorit Kryesor të EULEX të atëhershëm Z. Johannes Van Vreeswijk me më shumë se 5.000 nënshkrime online dhe ndryshimi i tabelës së emrit të një prej rrugëve kryesore të Prishtinës në emër të Johannes Van Vreeswijk. Shiko në <http://www.facebook.com/home.php?c!/group.php?gid=120818897938391>

t'i japin fund gati 10 viteve të mosndëshkueshmërisë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

KIPRED ka ndërmarrë këtë analizë në mënyrë që të vlerësojë reagimin aktual të autoriteteve të Kosovës dhe Misionit të BE-së për Sundim të Ligjit ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit në mënyrë që të garantohet respektimi i plotë i sundimit të ligjit në Kosovë. Në këtë fazë kyçe të procesit të saj të shtet-ndërtimit, Kosova do të duhet të dëshmojë se do të adresojë seriozisht problemet e krimit të organizuar dhe korrupsionit. E tëra kjo duhet të ndodhë në mënyrë që të garantohet respektimi i plotë i sundimit të ligjit, që do të mbetet si një nga prioritetet kyçe për një Kosovë që synon antarësimin në Bashkimin Evropian në vitet e ardhshme.⁴

Kjo analizë politikash shikon nivelin e reagimit aktual, duke analizuar rregulloret dhe kapacitetet implementuese të cilat i posedojnë shërbimet gjyqësore, prokuroriale dhe policore të Kosovës në hetimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kjo analizë shikon për së afërmi reagimin e qeverisë ekzekutive dhe mbështetjen e dhënë ndaj shërbimeve gjyqësore, prokuroriale dhe atyre policore. Me këtë nuk mëtohet të vlerësohen kapacitetet administrative për të luftuar korrupsionin thellësisht, por të fokusohet në kapacitetet gjyqësore dhe prokuroriale. Ky punim gjithashtu identifikon sfidat kryesore dhe propozon mënyra praktike për t'i kapërcyer zbrastësitat e identifikuar.

METODOLOGJIA

Hulumtimi për këtë punim është bërë nga prilli deri në nëntor të vitit 2010. Gjatë kësaj periudhe, KIPRED është takuar dhe ka bërë intervista të gjysmë strukturuara me grupet e interesit në Kosovë të përfshira në çështjet e sundimit të ligjit. Ofruesit kryesorë të informatave ishin zyrtarë nga qeveria, shërbimet gjyqësore, prokuroriale dhe policore duke përfshirë stafin e misioneve ndërkombëtare dhe donatorët. Përpiluesit po ashtu kanë mbledhur dhe janë konsultuar me të dhëna dhe materiale dytësore, si (1) literaturën, raportet dhe statistikat relevante mbi sundimin e ligjit në përgjithësi dhe mbi situatën në Kosovë; (2) punimet strategjike dhe legjislacionin; dhe (3) informata e ofruara nga

⁴ Shih Raportin e Komisionit të Komuniteteve Evropiane "Kosovo under UN SCR 1244/99 2010 Progress Report" (Nëntor 2010)

donatorët ndërkombëtarë që mbështesin projekte të ndërlidhura me sundimin e ligjit në Kosovë. Raporti po ashtu ka shikuar zhvillimet e vazhdueshme në nivelin qendror duke përfshirë iniciativat legislative dhe ekzekutive si dhe implementimin e tyre.

Ky punim së pari shikon kapacitetet aktuale strukturore të grupeve kryesore të interesit. Pastaj vazhdon me një seksion në të cilin analizohen zhvillimet aktuale në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit duke u fokusuar në korrupsionin e nivelit të lartë dhe trafikimin me qenie njerëzore me qëllim të eksploatimit seksual. Analiza e politikave përfundon me të gjeturat kryesore dhe rekomandime për grupet e interesit bazuar në mangësitë e identifikuara.

II. PRAPAVIJË E SHKURTËR

Bashkësia ndërkombëtare dhe qeveria e Kosovës janë pajtuar se sundimi i ligjit duhet të jetë një prioritet për Kosovën tani pas shpalljes së pavarësisë. Trashëgimia e UNMIKut e afro 10 viteve të pandëshkueshmërisë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit përfundoi me shtrirjen e Misionit të BE-së për sundim të ligjit – EULEX. Shtrirja e misionit filloi në vitin 2008 dhe ishte përkrahur edhe nga autoritetet e sapozgjedhura të Kosovës që pranonin dobësitë e shtetit të Kosovës në garantimin e sundimit të ligjit dhe kishin ftuar komunitetin ndërkombëtar të vendoste një mision të sundimit të ligjit.⁵ Sipas kësaj, EULEX-i ka mandat të “monitoroj, mentorojë, dhe këshillojë institucionet kompetente kosovare në të gjitha fushat e lidhura me sundimin më të gjerë të ligjit,” siç shpjegohet në mandat, “duke i rezervuar disa përgjegjësi ekzekutive” dhe “t’i ekzekutojë këto bashkë me mbështetjen e qeverisë kosovare në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë.”⁶ Misioni po ashtu duhet të sigurojë që Kosova plotësisht do të hetojë, ndjekë penalisht, gjykojë dhe zbatojë ligjin në rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve tjera serioze.

⁵ Paragrafi 5 në Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, 17 shkurt 2008 – në http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Dek_Pav_e.pdf

⁶ Shih “*The Joint Action Plan of the Council of European Union, 2008/124/CFSP*” (2008) dhe Propozimin Gjithpërfshirës të Marrëveshjes për Status të Kosovës, Kreu II. Paragrafi 12 dhe neni 3, paragrafi 3 i Ligjit të Parlamentit të Kosovës Nr.03/L mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX në Kosovë.

Sidoqoftë, gati tre vite pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, sundimi i ligjit vazhdon të shikohet si një nga fushat më të dobëta të qeverisjes në Kosovë. veçanërisht lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është vlerësuar si një nga proceset më të dobëta në të cilat ka kaluar Kosova, ndikuar nga mungesa e vullnetit politik që kontribon në performancën e dobët të Kosovës në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.⁷ Mungesa e historisë në hetimin, përndjekjen dhe dënimet në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar është identifikuar si dobësi e Kosovës në garantimin dhe mbështetjen e sundimit të ligjit.⁸ Situata e krijuar po ndikon gjithnjë e më shumë në investimet e huaja dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës.⁹ Gjithnjë e më tepër, qytetarëve të Kosovës u rritet dyshimi në vullnetin e institucioneve të Kosovës për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

III. PASQYRA INSTITUCIONALE

Në Kosovë ekzistojnë struktura të ngatërruara dhe konfuze për mbrojtjen e funksionimit dhe arritjen e sundimit të ligjit. Agjencitë kosovare të zbatimit të ligjit, si dhe institucionet gjyqësore dhe ato prokuroriale janë në krye në këtë fushë, të përkrahura nga EULEX – Misioni për Sundim të Ligjit si pjesë e Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP). Strukturat e BE-së po ashtu përkrahen nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil (ICR) i cili udhëheq Zyrën Ndërkombëtare Civile me një mandat të dyfishtë edhe si Përfaqësues Special i BE-së (PSBE) në Kosovë. Niveli i llogaridhënies bëhet edhe më i ndërlikuar me faktin se ICR-ja gëzon disa fuqi specifike korrigjuese dhe i raporton Grupit Drejtues Ndërkombëtar,¹⁰ ndërkaq PSBE-ja i raporton Brukselit. Edhe pse EULEX është një mision teknik, ai pranon udhëzime politike nga PSBE-ja mbi aspektet e implementimit të mandatit të vet ekzekutiv.¹¹ Sa i përket pavarësisë së Kosovës, misioni është “neutral ndaj statusit”, në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit

⁷ Raporti i Komisionit për Komunitete Evropiane “Kosovo under UN SCR 1244/99 2010 Progress Report” (Nëntor 2010).

⁸ Ibid. tek fusnota 7

⁹ Shih për shembull Informata nga Departamenti i Shtetit i SHBA, 2009 Deklarata për Klimën e Investimit për Byronë Kosovare të Çështjeve Ekonomike, Energjetike dhe Biznesore tek <http://www.state.gov/e/eeb/rls/othr/ics/2009/117388.htm>, Shkurt, 2009

¹⁰ ISG-ja është formuar pas kërkesës zyrtare të udhëheqësve kosovar në shkurt 2008. Grupi është i përbërë nga 25 shtetet që kanë njohur pavarësinë e Kosovës duke përfshirë fuqitë kryesore perëndimore që po ashtu inkurajojnë qeverisjen e sundimit të ligjit në Kosovë. ICR, në mes tjerash, mund të anulojë vendime ose ligje nga autoritetet kosovare dhe të heqë zyrtarë publikë nëse veprimet e tyre janë kontradiktore me dispozitat e marrëveshjes. Shih <http://www.ico-kos.org/pdf/presseng28.pdf> dhe “Comprehensive Status Proposal” në <http://www.ico-kos.org/d/Ahtisaari%20Comprehensive%20Proposal%20in%20English.pdf>

¹¹ Shih Vendimin e Këshillit 2010/466/CFSP mbi “Zgjerimin e Mandatit të Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian në Kosovë,” (11 gusht 2010) tek <http://www.eusrinkosovo.eu/d/LexUriServ11082010.pdf>

të Sigurimit të OKB-së, duke qenë që pesë shtete të Bashkimit Evropian ende s'e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur.

Misioni më i madh që ka nisur ndonjëherë ESDP-ja, u nis shumë ngadalshëm, duke u ballafaquar me shumë sfida, shumicën e të cilave misioni është duke mësuar se si t'i përballojë. Me 6 prill 2009 Misioni i EULEX shpalli se është në gjendje të plotë operacionale, katër muaj pas fillimit të fazës së vet operative.¹² Numri përfundimtar i synuar i personelit ishte planifikuar të ishte rreth 3200 prej të cilëve 1950 gjyqtarë, prokurorë, policë dhe zyrtarë ndërkombëtarë doganash, duke përfshirë edhe 1250 personel lokal.¹³ Për shkak të ritmit të ngadalshëm të vendosjes dhe sidomos për shkak të krizës globale financiare, "kapaciteti i plotë operacional" i tanishëm përmban 1382 nga personeli ndërkombëtar dhe 1100 nga personeli lokal, që tregon një tendencë të zvoglimit.¹⁴ EULEX, përkundër përpëlitjes me kornizën e vet politike dhe funksionimin e vet si mision teknik, është mision kryesor ndërkombëtar në lidhje me sundimin e ligjit në Kosovë.

Pronësia dhe qëndrueshmëria e MMK-së si dhe fuqive ekzekutive mund të garantohet vetëm përmes kryesimit nga institucionet kosovare në çështjet e sundimit të ligjit në Kosovë.¹⁵ Strukturat aktuale operacionale të misionit kanë 62% të personelit ndërkombëtar të angazhuar në përgjegjësi të ndryshme ekzekutive, përfshirë edhe kontrollimin e turmave/trazirave dhe ruajtjen e rendit publik. Duke ushtruar mandat të dyfishtë, në MMK dhe fushat ekzekutive,¹⁶ gjyqtarët dhe prokurorët e tyre së bashku me gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës, në mes të tjerash, kanë për detyrë të vazhdojnë luftën kundër krimit të organizuar, krimit serioz financiar dhe krimeve të luftës.

Si një nga shtyllat kyçe të sundimit të ligjit në Kosovë, shërbimet e prokurorisë dhe gjykatave në përgjithësi me strukturat e tyre aktuale vazhdojnë të jenë të neglizhuara rëndë ngase shtetet anëtare të BE-së kanë sjellur në Kosovë vetëm 60 gjykatës dhe

¹² Komunikatë Shtypi e BE-së tek <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0049.php>

¹³ Tek <http://www.eulex-kosovo.eu/en/info/whatisEulex.php>

¹⁴ Një shembull ilustrues është Mbretëria e Bashkuara, një nga përkrahësit kyç të misionit të EULEXit, e cila vendosi të zvoglojë stafin e vet përgjysmë. Shih *Global Crisis Boosts Kosovo Independence, Balkan Insight, March 27, 2009*, <http://www.balkaninsight.com/en/main/news/17732/>. Komunikime me e-mail në mes KIPRED dhe Zyrës së Programit të EULEX, maj 2010.

¹⁵ Shih Raportin e Programit të EULEX 2009.

¹⁶ Misioni po ashtu përpiloi një MMK Mekanizëm të Ndjekjes në fushat e policimit, drejtësisë dhe doganave me synime dhe rekomandime specifike të cilat institucionet e Kosovës do të duhej t'i përmbushnin në përputhje me Praktikat më të Mira Evropiane. Shih uebfaqen e misionit EULEX në www.eulex-kosovo.eu/en/tracking.

prokurorë. Për dallim, departamenti i policisë speciale ka më shumë se 550 policë të vendosur në kontenierë të EULEX-it të përgatitur për të reaguar nëse është e nevojshme për të kontrolluar turmat dhe trazirat. Në njërin anë, më pak se 10% e personelit ndërkombëtar të misionit EULEX përbëhet nga gjykatës dhe prokurorë, ndërsa në anën tjetër më shumë se 550 policë vazhdojnë të qëndrojnë në Kosovë për kontrollim të turmës dhe trazirave.¹⁷ Raporti i fundëm i Progresit nga BE vlerëson se kapacitetet e policisë së Kosovës janë rritur në kontrollimin e demonstratave dhe turmave,¹⁸ përderisa gjyqësia dhe prokuroria kanë vështirësi të plotësojnë mandatin e tyre.




Figura 1 – Staf i EULEX-it

Misioni deklaron se është ballafaqur me vështirësi në rekrutimin e një numri më të madh të gjykatësve dhe prokurorëve, ngase shtete individuale anëtare të BE-së hasin vështirësi në rekrutimin ose dërgimin e gjykatësve dhe prokurorëve në misione për periudha më të gjata kohore.¹⁹ Struktura aktuale e personelit të EULEX-it është e ndryshme nga prioritetet e misionit. Aktivitetet e saja të MMK mund të kenë një ndikim më afat-gjatë duke u shndërruar në përpjekje jetëgjata dhe të qëndrueshme, përderisa kompetencat ekzekutive kanë ndikim më pak të qëndrueshëm.

¹⁷ Shih Tabelën 1. Figura e marrë nga komunikimi me e-mail në mes KIPRED dhe zyrës së programit EULEX, maj 2010 dhe tetor 2010.

¹⁸ Raporti i Komisionit të Komuniteteve Evropiane “Kosovo under UN SCR 1244/99 2010 Progress Report” (nëntor 2010) fq. 55

¹⁹ Intervista e KIPRED me Zëvendës Udhëheqësin e EULEX Z. Roy Reeve, maj 2010.

a) Institucionet e Kosovës

Gjyqësori, prokuroria dhe policia janë ndër tri shtyllat kryesore institucionale në Kosovë që e në mes tjerash kanë mandatin për hetimin, përndjekjen dhe dënimin e krimeve të luftës, krimin të organizuar, krimin ekonomik dhe korrupsionit. Në vitin 2006 Kosova kishte themeluar Agjencinë Anti-Korrupsion, e cila është funksionalizuar në shkurt të vitit 2007. Kjo agjenci e pavarur i raporton Parlamentit të Kosovës, duke kërkuar dhe menaxhuar buxhetin e vet në mënyrë të pavarur.²⁰ Në fund të vitit 2009 stafit të Agjencisë u ishte aprovuar pagesa shtesë për t'ia mundësuar atyre përmbushjen e rolit të vet. Agjencia bën hetime administrative në aktivitetet e zyrtarëve apo shërbyesve publik dhe nëse ekziston dyshim për sjellje korruptive i referon rastet për hetime prokuroriale. Sfidat me të cilat është përballë Agjencia në muajt e fundit, të shkaktuara nga mungesa e mbështetjes financiare dhe në burime njerëzore nga trupi ekzekutiv dhe legjislativ, janë tejkaluar.²¹ Parlamenti i Kosovës miratoi financim më të madh për Agjencinë duke shtuar në masë të madhe pagesën financiare për staf.²² Agjencia ka zgjeruar rolin e vet duke nënshkruar memorandume të mirëkuptimit me institucione të ndryshme siç është Policia e Kosovës. Ka pësuar një rritje në mirëkuptim të rolit dhe mandatit të Agjencisë.

Për shembull, Policia e Kosovës së fundi ka anuluar një ftesë për tender pasi që Agjencia kishte shprehur dyshimet e saja se kishte dyshime për sjellje korruptive në këtë rast.²³ Drejtori ekzekutiv i Agjencisë, Z. Preteni, dhe një Prokuror i Lartë i EULEX-it përkrahën rolin parandalues që Agjencia duhet të luajë në zvogëlimin e dëmtimit të buxhetit të Kosovës, nëse sjellje potencialisht korruptive vërehen dhe parandalohen me

²⁰ Po ashtu shih Ligjin e Parlamentit të Kosovës Kundër Korrupsion Nr.2004/34 dhe Ligjin e Parlamentit të Kosovës mbi Agjencinë Anti-Korrupsion, nr. 03/L-059 në <http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,193>.

²¹ Parlamenti i Kosovës ka miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsionit dhe ka dekretuar Ligjin mbi Agjencinë Anti-Korrupsion, Ligji për Ndryshimin dhe Përmirësimin e Ligjit Nr. 02/L-133 mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik dhe Ligji mbi Deklarimin e Prejardhjes së Pronës dhe Dhuratave për Zyrtarë të Lartë Publik. Shih uebfaqen e Parlamentit të Kosovës <http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,193>.

²² Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Anti-Korrupsion të Kosovës, Z. Preteni, ka vlerësuar dekretimin e ligjeve të nevojshme, miratimin e buxhetit total nga Parlamenti i Kosovës siç është sygjeruar nga agjencia, në vlerë prej € 514,338, rivendosjen e Agjencisë prej zyrave me qira në zyra të zotëruara nga shteti. Nga fillimi i 2010 zyrtarët e Agjencisë marrin pagesa mujore shtesë për shkak të ekspozimit ndaj rrezikut.

²³ Rasti përfshinte blerjen e automjeteve të reja për Policinë e Kosovës përmes një procedure publike të furnizimit. Zyrtarët e Agjencisë Anti-Korrupsion të Kosovës, pasi që analizuan thirrjen e tenderit vërejtën se specifikimet për tenderin dhe dizajni i kriterëve ishin të përpiluara në një mënyrë që do të çonte drejt zgjedhjes dhe promovimit të një shitësi/prodhuesi specifik nga komiteti i furnizimit. Në kundërshtim me Ligjin e Furnizimit Publik në Kosovë, Agjencia bëri thirrje që thirrja për tender të anulohet, gjë që është plotësuar nga menaxhmenti i PK-së.

kohë.²⁴ Prandaj, sigurimi i burimeve njerëzore dhe financiare për të përkrahur rolin parandalues të agjencisë është për tu lëvdur.

Në anën tjetër, edhe pse Agjencisë u janë plotësuar kërkesat për burimet njerëzore dhe buxhetore në mënyrë adekuate gjatë 2009, ajo dështoi të reagojë me kohë në realizimin e hetimeve administrative mbi deklarin e pasurisë nga zyrtarët e lartë. Mospërputhshmëria në mes të hyrave të zyrtarëve të lartë dhe pasurisë së deklaruar është reflektuar edhe në Raportin e Progresit të BE për vitin 2010. Zhvillimi i hetimeve administrative është i kufizuar dhe e zbuloi vështirësinë e Agjencisë për tu adaptuar kërkesave të reja ligjore të parapara nga Ligji për Deklarimin e Pasurisë së Zyrtarëve Publik.

Për më tepër, reimbursimi i humbjeve të cilat i janë shkaktuar buxhetit të Kosovës, të cilat kanë ndodhur apo mund të ndodhin nga sjelljet korruptive, duhet të hetohet në plotësi. Sipas KIPRED-it, viteve të fundit në qendër të vëmendjes ishin kapacitetet hetuese administrative brenda Kosovës në vend se të ishin shërbimet gjyqësore, prokuroriale dhe policore. Qeveria e Kosovës ka dështuar të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për gjyqësorin dhe prokurorinë në mënyrë që t'ia mundësojë atyre të përmbushin në mënyrë profesionale dhe të pavarur kompetencat e veta.

b) Shërbimet Gjyqësore dhe Prokuroriale

Sistemi i drejtësisë në Kosovë është i menaxhuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) si një trup i pavarur që do të duhej të garantonte pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor.²⁵ KGJK po ashtu udhëheq prokurorët, ngase Parlamenti i Kosovës vetëm së fundi ka dekretuar Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), i cili ende nuk është operacional. Përerisa KPK-ja nuk funksionon, Ministria e Drejtësisë (MeD) do të menaxhojë administrimin e shërbimeve prokuroriale së bashku me KGJK e cila është përgjegjëse për shërbimet prokuroriale.

²⁴ Intervistë e KIPRED me Drejtorin Ekzekutiv Z. Hasan Preteni, maj 2010 dhe me prokurorin e lartë të EULEX, qershor 2010.

²⁵ Për një pasqyrë më të detajuar të mandatit të shërbimeve gjyqësore dhe prokuroriale shih Analizën e Politikave të KIPRED “Trekëndëshi i brishtë- Koordinimi i policisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë procedurës penale në Kosovë” (shkurt 2010) në http://www.kipred.net/ceb/upload/The_Fragile_Triangle.pdf.

Reagimi i ngadalshëm i qeverisë së Kosovës dhe Parlamentit të Kosovës në dekretimin e ligjeve bazë për gjyqësorin dhe prokurorinë si p.sh. Ligjin për Gjyqet, Ligjin për Këshillin Prokurorial, Ligjin për Prokurorinë Shtetërore, kanë penguar zhvillimin e këtyre institucioneve vitale gjatë tri viteve të fundit. Sidoqoftë, Kosova ka arritur të nisë një reformim të sistemit të vet gjyqësor dhe prokurorial. Implementimi i këtyre ligjeve të sapo dekretuara²⁶ ka rritur në mënyrë të konsiderueshme pagesat për gjyqtarët dhe prokurorët. Mbetet të shihet nëse këto premtime do të reflektohen edhe në Buxhetin Vjetor të Kosovës për vitin 2011 nga qeveria e re e cila pritet të zgjedhet²⁷ në zgjedhjet parlamentare të Kosovës. Prokurorët publik ankohen se do të duhen të vazhdojnë të punojnë pa një udhëzues të vërtetë profesional, duke qenë që Këshilli Prokurorial i Kosovës ende nuk është bërë funksional, ndonëse është paraparë të themelohet me Kushtetutën e Kosovës në vitin 2008.²⁸

Pas pavarësisë, shërbimet prokuroriale të Kosovës kanë vazhduar të përmbushin funksionet e tyre me rreth vetëm 70% të kapaciteteve njerëzore të parapara.²⁹ Deri në fund të vitit 2008 Kosova kishte miratuar 122 pozita prokuroriale. Procesi i verifikimit dhe ri-emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të përfundojë deri në fund të vitit 2010.³⁰ Në qershor të vitit 2010,³¹ 78 prokurorë punonin në zyrat e Prokurorisë komunale, të qarkut dhe ate Publike të Kosovës duke përfshirë edhe Zyrën e Prokurorëve Special të Kosovës, që do të thotë se janë *3.53 prokurorë për 100.000 banorë*. Gjatë vitit 2009, Zyra e Prokurorisë Publike të Qarkut të Prishtinës, një nga shërbimet kyçe prokuroriale në hetimin dhe përndjekjen e shumicës së rasteve komplekse në Kosovë,³² ka operuar me vetëm 3 prokurorë apo *1.57 prokurorë për 100.000 banorë duke*

²⁶ Parlamenti i Kosovës ka kaluar Ligjin e Kosovës për Këshillin Prokurorial, Ligjin për Prokurorinë Shtetërore, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin për Gjykata gjatë periudhës korrik-tetor 2010. Lexo në <http://www.ks-gov.net/GazetaZyrtare/GZ2010.aspx>

²⁷ Zgjedhjet e reja parlamentare janë vendosur në 12 dhjetor 2010, pas votës së mos-besimit të qeverisë nga Parlamenti i Kosovës me 2 nëntor 2010. Vota e mosbesimit është pasuar nga shpërndrja e Parlamentit të Kosovës, si rezultat i një krize politike në Kosovë pas tërheqjes së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) nga koalicioni qeverisës me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) në tetor 2010.

²⁸ Komunikim i KIPREDit me Prokurorin Shtetëror të Kosovës, tetor 2010.

²⁹ Nga ky numër vetëm 78 prokurorë janë duke punuar me 3 prokurorë të suspenduar, 2 prokurorë serbë kanë lënë shërbimet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Gjyqi i Qarkut në Mitrovicë vazhdon të mos jetë funksional si rezultat i demonstratave të serbëve të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Shih "Raportin Vjetor" 2009 i Zyrës së Prokurorisë Shtetërore dhe "Raport mbi Burimet Njerëzore të Prokurorisë Publike të Republikës së Kosovës - Çereku i dytë i 2010", Zyra Statistikore dhe e Analizave, Ministria e Drejtësisë.

³⁰ Vonesat e hyrjes së gjeneratës së re të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë shkaktuar edhe nga vonesa dy vjet e gjysmëshe e Parlamentit të Kosovës në funksionalizimin e kushteve për procedurën e provimit të jurisprudencës.

³¹ Ministria e Drejtësisë, raport gjashtë mujor

³² Gjykata e Qarkut në Prishtinë mbulon juridiksionin më të madh territorial me një numër të përafërt prej 1 milion banorësh. Shih Seksionin e Monitorimit të Sistemit Ligjor në Raportin Mujor të OSBE-së më qershor 2009, fq.2.

mbuluar tërë Qarkun e Prishtinës.³³ Në krahasim me vendet tjera Kosova mbetet me përqindjen më të ulët të prokurorëve për 100.000 banorë. KIPRED po ashtu ka vërejtur se gjatë vitit 2010 ka pasur një rënie të numrit të prokurorëve, si pasojë e procesit të verifikimit dhe riemërimit, gjë që reflektohet në një rënie prej 88 në 78 prokurorë. Ky është një fakt brengosës për përmbushjen efikase të funksioneve prokuroriale dhe për mbrojtjen e sundimit të ligjit.³⁴

Numri i Prokurorëve		
	Dhjetor 2009	Qershor 2010
Prokuroria e Kosovës	6	5
Prokuroritë Komunale	48	37
Prokuroritë e Qarkut	28	26
Prokuroria Speciale	6	10
TOTAL	88	78

Tabela 1 – Numri i përgjithshëm i prokurorëve 2009 dhe tremujori i dytë 2010

Mungesa e personelit prokurorial pengon zhvillimin e prokurorëve të specializuar në hetim dhe përndjekje të krimeve specifike në lidhje me korrupsion dhe krim të organizuar. Sistemi aktual prokurorial është pak a shumë gjenerik me vetëm disa prokurorë të veçantë të emëruar si anëtarë të Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës (ZPSK). Përveç kësaj, dhjetë prokurorë publik janë emëruar si pjesë e Task Forcës Anti-Korrupsion (Task Forca) brenda ZPSK-së.

Institucione kyçe prokuroriale vazhdojnë të punojnë në objekte jo adekuate si për shembull Këshilli Gjyqësor i Kosovës i cili është i vendosur në një ish- kontenier të UN-it, apo të tjerë që vazhdojnë të mbajnë me qera objekte jo të përshtatshme. Sipas fjalëve të Prokurorit Shtetëror të Kosovës, burimet njerëzore dhe financiare janë më se të rëndësishme për të mundësuar prokurorët të përmbushin mandatin e tyre “...puna e

³³ Në përputhshmëri me “normën vjetore” të kalkuluar nga Ministria e Drejtësisë bazuar në numrin e padive kriminale dhe numrin e banorëve të mbuluar nga gjykatat respektive, kalkulimet e fundme të Ministrisë së Drejtësisë në Kosovë (MeD) sygjerojnë që Kosova është dashur të ketë 171 prokurorë në total në të gjitha rastet me 7.74 % prokurorë për 100.000 banorë. Kalkulimet janë të përafërta me praktikat regjionale të vendeve fqinje siç është Mali i Zi, i cili ka 13.4, Bosnia dhe Hercegovina me 7.3 dhe Hungaria me 17.3 prokurorë për 100.000 banorë. Vetëm Franca ka 2.9 prokurorë për 100.000 banorë. Për më shumë shih botimin e KIPRED “Trekëndëshi i brishtë” shkurt 2010

³⁴ Sigurimi i kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare të prokurorisë është një parakusht për përf forcimin e kapaciteteve prokuroriale për mbrojtjen e sundimit të ligjit.

zyrës sime u kushton institucioneve kosovare përafërsisht 6.094 euro në muaj...nuk e kuptoj se si një betejë mund të luftohet pa ‘ushtar[ë]’...³⁵ KIPRED po ashtu ka vërejtur një zvoglim të mbështjejes buxhetore pas viti 2008 për forcimin e institucioneve gjyqësore dhe prokuroriale. Për shembull, mbështetja për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ka rënë për çdo vit përafërsisht për 0.10-0.15 % nga buxheti i përgjithshëm.³⁶ Mesatarja e buxhetit të përvitshëm të Kosovës që nga 2008 për KGJK-në përmbanë përafërsisht 1% të buxhetit të përgjithshëm vjetor. Gjatë vitit 2010 KGJK është mbështetur me 1.16% të totalit të buxhetit të Kosovës. Për dallim, Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, e cila është momentalisht nën hetim nga Misioni i EULEX në Kosovë për shkak të dyshimeve në sjellje korruptive të disa zyrtarëve të saj, në vitin 2010 u është caktuar 17% e buxhetit të të përgjithshëm vjetor të Kosovës.

Në realitet, prioritetet qeverisëse kanë qenë të drejtura ndryshe, duke rritur mbështetjen për projekte të investimit kapital në ndërtim dhe rindërtim rrugësh duke shtyer mbështetjen për shërbime efikase gjyqësore dhe prokuroriale, për një mandat tjetër të mundshëm pas zgjedhjeve parlamentare të 12 dhjetorit 2010.




Figura 2 – Buxheti vjetor i Kosovës, 2007-2010

³⁵ Intervista e KIPRED me Prokurorin Shtetëror të Kosovës, qershor 2010. Kjo deklaratë është cituar nga takimi i Prokurorit Shtetëror me Kryeministrin e Kosovës për të diskutuar nevojat e shërbimit prokurorial në Kosovë.

³⁶ Shih Tabelën 2.

Kushtet, siç janë numri i pamjaftueshëm i personelit, pagesa dhe stimulime financiare jo adekuate për prokurorët specialë duke përfshirë edhe kushte jo adekuate të punës, do të vazhdojnë të shoqërojnë punën e shërbimeve prokuroriale, të cilat do të duhen të punojnë me atë çka kanë në dispozicion, pra sistemin aktual të shumë kritikuar. Vëmendja adekuate politike dhe përkrahja e qeverisë dhe e degës legislative do të duheshin të krijojnë kushtet që prokurorët të përmbushnin mandatin e tyre dhe të mbrojnë sundimin e ligjit në Kosovë.

c) Përkrahja e EULEX

Momentalisht, EULEX-i ka në dispozicion 20 prokurorë, të cilët gjithashtu praktikojnë edhe mandatin e tyre MMK. Nga numri total i 1382 të personelit ndërkombëtar, më pak se 20% e misionit është e përbërë nga gjykatës, prokurorë dhe staf policor ekzekutiv që punojnë drejtpërsëdrejti vetëm në mandatin e vet ekskluziv.³⁷ Edhe pse autoritetet kosovare udhëheqin hetimet dhe përndjekjen e krimeve serioze, për shkak të sensitivitetit të rasteve si dhe për shkak të mosgatishmërisë në të kaluarën të prokurorëve kosovarë të merren me rastet e mëdha të krimit të organizuar dhe korrupsionit, numri i njerëzve që EULEX-i ka në dispozicion momentalisht është shumë i vogël. Ky fakt është pranuar edhe nga misioni i cili ka synuar të rrisë dhe të rekrutojë një numër më të madh prokurorësh.³⁸ Procesi i rekrutimit ka qenë i ngadalshëm dhe ende s'ka dhënë rezultate të dëshirueshme. Për më tepër, rotacioni i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë ka qenë një pengesë në hetimin dhe përndjekjen efikase të krimeve, në veçanti të rasteve të krimit të organizuar. Siç i është thënë KIPRED-it, një nga prokurorët ka qenë prokurori i katërt që ka marrë në dorë dosjen e një rasti të hetuar të krimit të organizuar.³⁹ Mesatarisht, një prokuror i EULEX qëndron në Kosovë prej gjashtë deri në dymbëdhjetë muaj duke shkaktuar vonesa në hetimin me kohë të rasteve.

Për më tepër, një nga pengesat në luftimin e korrupsionit, në veçanti atë të hetimit dhe përndjekjes së zyrtarëve të lartë, është parë edhe problemi i thyerjes së lidhjeve familjare që janë ndërtuar me vite dhe të cilat kanë të ndërlidhura një numër të madhe të

³⁷ 199 personel ndërkombëtar punojnë në Komponentën e Drejtësisë në misionin e EULEX. Komunikim e-maili me Zyren e Krye Prokurorit të EULEX, tetor 2010. Po ashtu komunikim me email me Zyren e Programit të EULEX, prill dhe tetor 2010.

³⁸ Intervistë e KIPRED me ish-zëvendës kryesuesin e EULEX, Z. Roy Reeve, qershor 2010.

³⁹ Intervistë e KIPRED me ish-këshilltar të politikave për Drejtësi në EULEX, tetor 2010

interesave.⁴⁰ Bashkëpunimi i dëshmitarëve është thelbësor në disa raste të korrupsionit. mungesa e ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe madhësia gjeografike e Kosovës janë pengesa në arritjen e rezultateve pa dëshmi të dokumentuara dhe hetime të fuqishme të shërbimeve të inteligjencës. Misioni EULEX po ashtu ka vazhduar të punojë kryesisht në mënyrë të pavarur në veçanti në hetimin e rasteve të korrupsionit. Prokurori Shtetëror i Kosovës ka deklaruar për KIPRED se hetimi i zyrtarëve të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit u është bërë e ditur prej EULEXit në po të njëjtën ditë që ka filluar hetimi.⁴¹ Kjo neglizhencë e EULEX ndaj prokurorisë shtetërore të Kosovës është brengosëse, ngase nuk përputhet me misionin e EULEX-it për të ndërtuar kapacitetet e institucioneve kosovare të sundimit të ligjit.

d) Shërbimet gjyqësore

KIPRED ka vërejtur probleme të ngjashme edhe në shërbimet gjyqësore, siç janë numri i pamjaftueshëm i gjykatësve dhe stafit profesional përkrahës, pagesa e vogël dhe kushte jo adekuate të punës. Edhe me afrimin e fundit të procesit të verifikimit dhe riemërimit,⁴² Kosova mbetet me një numër të pamjaftueshëm të gjykatësve. Me përfundimin e procedurës së verifikimit, Kosova ka 12.41 gjykatës për 100,000 banorë. Në krahasim me vendet tjera në rajon Kosova vazhdon të ketë gati tri deri në katër herë më pak gjykatës.⁴³ Për më tepër, gjykatësit e EULEX-it përballen me vështirësi të ngjashme me staf brenda gjykatave. Në total janë 37 gjykatës të EULEX që ndihmojnë autoritetet gjyqësore kosovare.⁴⁴ Në gjykatat e Pejës, Gjilanit dhe Prizrenit, gjatë vitit 2009 EULEX ka punuar vetëm një gjykatës penal, që ka pasur ndikim në themelimin e paneleve të gjyqimit. Numri origjinal i synuar i gjykatësve brenda misionit të EULEX-it është larg nga realizimi. Në shumicën e rajoneve nuk ka hapësirë të mjaftueshme në ndërtesën e gjyqit të qarkut dhe disa nga gjykatësit e EULEX-it vendosen në ish-ndërtesat e UNMIK-ut larg nga homologët e tyre lokalë.⁴⁵ Këto kushte jo adekuate të punës kanë pasur ndikim në punën ekipore dhe koordinimin e rasteve me gjyqësinë lokale.

⁴⁰ Email komunikim i KIPREDit me Kryeprokurorin e EULEX, tetor 2010.

⁴¹ Intervistë me Prokurorin Shtetëror të Kosovës, korrik 2010.

⁴² KGJK së bashku me Komisionin Ndërkombëtar Gjyqësor dhe Prokurorial kanë finalizuar ri-emërimin e gjykatësve anëmbanë Kosovës. Më shumë se gjysma e gjykatësve janë rizgjedhur nëpër nivele të ndryshme.

⁴³ Për shembull Kroacia në fund të 2009ës ka pasur 42.48 gjykatës dhe Serbia 30.05 gjykatës për 100.000 banorë.

⁴⁴ Komponenta e Drejtësisë e misionit në tërësi përfshin gjykatës, prokurorë dhe policë ekzekutiv, që përbëjnë vetëm 16% të kapacitetit total të EULEX.

⁴⁵ Raporti Vjetor i Gjykatësve të EULEX 2009, në <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual-report2009/ANNUAL%20REPORT%20English%20FINAL.pdf>.




Figura 3: Krahasim i numrit të gjykatësve me vendet tjera

Kosova ka përfunduar procesin e vet të verifikimit dhe riemërimit të gjykatësve dhe prokurorëve.⁴⁶ Njëri nga efektet e parashikuara të procesit të verifikimit dhe riemërimit ishte edhe reduktimi i perceptimit negativ të cilin e kanë qytetarët për gjykatësit në veçanti, pasi që shpesh perceptohen si më së paku të suksesshëm prej institucioneve të Kosovës, që mund ti nënshtrohen sjelljeve korruptive dhe ndërhyrjeve politike.⁴⁷ Procedurat e detajuara të verifikimit kanë përfshirë edhe hetimin e KPGJP-së të pronës së patundshme të gjykatësve dhe prokurorëve, llogaritë e tyre bankare dhe intervistimi i tërthortë i kandidatëve dhe dëshmitarëve.⁴⁸ Përpos si shembull pozitiv në tejkalimin e perceptimit të shpeshtë të gjyqësisë si të korruptuar, ky proces dhe do të ketë edhe efekte shtesë në kapacitetet njerëzore dhe profesionale të gjykatësve.

Procesi i verifikimit dhe riemërimit ka lënë sistemin gjyqësor të brishtë me një numër të konsiderueshëm të gjykatësve dhe prokurorëve të sapa emëruar. Kjo nënkupton trajnime shtesë nën drejtimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës i cili do të duhet të koordinohet me Institutin Gjyqësor të Kosovës. Ky proces do të shkaktojë vonesa të konsiderueshme që gjyqet të bëhen plotësisht efikase. Përkrahja e zhvillimit të njohurisë lidhur me krimet e veçanta, siç është krimi i organizuar dhe rastet e korrupsionit, mbetet një sfidë e vazhdueshme edhe për KGJK-në. KGJK-ja duhet të zhvillojë një strategji trajnimi për

⁴⁶ Emërimet e fundit të kryera nga KGJK në tetor 2010.

⁴⁷ Raporti Tremujor Paralajmrimet të Hershme nga UNDP Kosovë dhe Raporti i Progresit nga KE për Kosovë 2010.

⁴⁸ Intervistë me Kreun e KGJK dhe KPGJP, shtator 2010.

gjykatësit e sapo emëruar në mënyrë që të përmbushin kërkesat e reja të parashtruara nga reformimi i gjyqësorit.

e) **Kapacitetet e policisë**

Policia e Kosovës (PK), si një prej shtyllave kyçe shtetërore të sundimit të ligjit, deri më tash ka qenë më e lëvduara për përkushtimin dhe profesionalizmin e saj si në raportet vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare. Si një shërbim i ri PK-ja ka arritur sukses të mjaftueshëm në vendosjen e rendit të përgjithshëm, po ashtu edhe në kontroll të trazirave.⁴⁹ BE-ja ka vlerësuar PK-në në raportin e vet të fundëm të 2010 si mjaftueshmërisht të kënaqshme në mirëmbajtje të qetësisë dhe rendit publik dhe në luftimin e krimeve të vogla. Përkundër mangësive të lartpërmendura në shërbimet gjyqësore dhe prokuroriale, një numër i konsiderueshëm i personelit që BE-ja vazhdon të mbajë në Kosovë janë policë për kontroll të trazirave dhe turmave.

Përkundër të lartpërmendurave dhe aktiviteteve MMK të Misionit të EULEX-it, në muajt e fundit performanca profesionale e PK-së shënuar rënje. Një nga arsytet ka qenë edhe struktura e keq planifikuar e EULEXit, i cili vazhdon të mbështesë policinë kryesisht në fushat ekzekutive.⁵⁰ Për dallim, BEja ka sjellur në Kosovë vetëm 48 zyrtarë dogane,⁵¹ përkundër faktit që shumica absolute e buxhetit të Kosovës mbledhet prej taksave në doganë dhe përkundër kritikizmit të autoriteteve kosovare⁵² në ndalimin e kontrabandimit të kryer nga krimi i organizuar. Këto dështime janë duke i shkatuar dëme të konsiderueshme buxhetit të Kosovës dhe mirëmbajtjes së një sundimi efektiv të ligjit në Kosovë.

Sfidat më të mëdha të PK-së në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit mbesin kapacitetet e veta stukturore dhe profesionale. Në përgjithësi, kjo ka ndikuar që hetimet e tyre të krimit të mbesin të kufizuara sa i përket hetimeve të udhëzuara nga shërbimet e inteligjencës, hetimeve proaktive dhe operacioneve të fshehta në hetimin e celulave të krimit të organizuar.

⁴⁹ *Raporti i Progresit Kosova 2010, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, nëntor 2010*

⁵⁰ Rreth 563 policë të EULEXit prej 1382 personeli ndërkombëtar qëndrojnë me bazë në kontienierë të EULEX duke pritur që të veprojnë për kontrollim të turmës ose demonstratave. Në total, prej 1382 personeli ndërkombëtarë të misionit të EULEX, 1,100 janë policë. Komunikim i KIPRED me Zyren e Programit të EULEX, tetor 2010.

⁵¹ Prej 72 personeli të doganave të vendosur, 48 janë ekzekutiv dhe 24 MMK. Komunikim me Zyren e Programit të EULEX, tetor 2010.

⁵² Më lart në fusnotën 50.

Nga viti 2009, komponenta policore e EULEX përmes aktiviteteve të veta MMK, ka punuar në implementimin një programi të sponsorizuar nga UNMIK-u⁵³ i cili synon të rrisë kapacitetet e PKsë për mbajtje të rendit të bazuar në shërbimet e inteligjencës dhe krijimit të një strategjie të vetme të shërbimeve të inteligjencës për krim. Një plan program i detajuar synon të rrisë kulturën e mbledhjes së informatave në bazë të shërbimeve të inteligjencës, përdorimit të formave dhe mbledhjes që përfshin sistemimin e të dhënave dhe analizimin e tyre për të planifikuar operacione proaktive. Rëndësia e mbledhjes së të dhënave dhe standardizimit të menaxhimit të dhënave është esenciale, edhe pse PK vazhdimisht është përballur me vështirësi në kapacitetet e veta strukturale dhe profesionale sa i përket hetimeve.

Është vërejtur mungesa e pajisjeve dhe stafit adekuat brenda dy drejtorive rishtazi të krijuara, Drejtoria Kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit dhe Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar.⁵⁴ Përveç kësaj, planifikimi proaktiv dhe ekzekutimi i operacioneve të udhëzuara nga shërbimet e inteligjencës, ku përfshihen operacionet e fshehta, dhe përdorimi i metodologjive sekrete si përgjimi i celularëve mbesin të pamundshme për të gjitha rrjetet të telefonisë mobile në Kosovë.⁵⁵ Në 2010, Komisioni Evropian raportoi se Drejtoria Kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, i cili duhet të udhëheq hetimet policore për krimet ekonomike dhe korrupsion, i është nënshtruar ndërhyrjeve politike.⁵⁶ KIPRED ka vërejtur edhe ndryshime në strukturën menaxhuese të PK-së dhe në emërimet e menaxhmentit të lartë brenda drejtorive respektive, që ishin të ndikuara nga nepotizmi apo lidhjet me partinë kryesore politike, njëherazi udhëheqëse e Ministrisë së Punëve të Brendshme.⁵⁷ Janë bërë ankesa edhe kundër ristrukturimit të brendshëm dhe gradimeve të bëra në bazë të preferencave politike e jo bazuar në përvojën apo performancën profesionale.⁵⁸

Misioni i EULEX me mandatin e tij të mentorimit, monitorimit dhe këshillimit nuk ka qenë në gjendje të parandalojë apo të nxjerrë në pah këto situata në mënyrë që të

⁵³ MMK në Policim i Udhëzuar nga Inteligjenca është zhvilluar mbi një model të Misionit të OSBE-së në Kosovë, si pjesë e administrimit të UNMIKut në Kosovë.

⁵⁴ Forumi për Iniciativë Civile dhe Instituti për Ligjin e Kosovës, “Sundimi i Ligjit: kapacitetet dhe funksionimet institucionale”, nëntor 2010.

⁵⁵ Ende nuk ekziston mundësia për të përgjuar telefonat mobilë të operatorit IPKO në Kosovë për qëllime hetuese.

⁵⁶ Fq. 12 dhe 56 në Raportin e Progresit të Kosovës, KE 2010

⁵⁷ Intervistë e KIPRED me ish Drejtorin në Detyrë të Policisë së Kosovës dhe përfaqësues i një ambasade të huaj në Kosovë, shtator 2010.

⁵⁸ Intervistë e KIPRED me dy zyrtarë të nivelit të mesëm në PK, gusht 2010.

garantojë forma që këto ri-emërime brenda PK-së të kryhen bazuar në kritere profesionale, pa ndërhyrje politike. Situata e gradimeve të bazuara në performancë do të duhet të përmirësohet me implementimin e aksioneve përcjellëse të MMK-së specifikisht të përpiluara për PK.⁵⁹ Përveç gradimeve dhe ristrukturimit të bazuar në performancë, PK-ja me përkrahjen e partnerit të vet EULEX, do të duhej të ishte më proaktive në gjetjen e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare për të mbështetur punën e Drejtorisë së Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit dhe Drejtorisë Kundër Krimit të Organizuar.

Këto mënyra të drejtpërdrejta të mbështetjes prej shteteve anëtare të BE-së do të kontribuonin proaktivisht në forcimin e mandatit të PK-së në hetimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke u bërë potencialisht një nga kontributet më të mëdha në suksesin e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit. Në të kundërtën, këto dobësi të identifikuar brenda policisë, pa marrë parasysh a janë strukturore a profesionale, do të vazhdojnë të dëmtojnë performancën e policisë.

IV. GJENDJA E KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Gjendja aktuale e reagimit gjyqësor dhe prokurorial ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit rrjedh nga struktura gabimisht e planifikuar e UNMIK-ut, i cili deri më 15 qershor 2008 kishte përgjegjësinë e plotë për fushën e krimeve të luftës, krimeve ndër-etnike dhe krimit të organizuar, të cilat në mënyrë qenësore kërcënojnë sundimin e ligjit në Kosovë. Si rezultat i mosefikasitetit të UNMIK-ut, rreth 500 dosje, prej të cilave 150 janë dosje penale, kanë mbetur të pazgjidhura me vite të tëra. Pjesa më e madhe e 150 dosjeve që EULEX-i ka trashëguar nga UNMIK-u janë pjesë e fushës së kompetencave ekskluzive të EULEX-it, domethënë ai është përgjegjës për rastet e krimeve të luftës, krimit të organizuar apo krimeve ndër-etnike. Gjatë vitit 2009, misioni i EULEX kryesisht është fokusuar në rastet e krimeve të luftës, vrasjeve dhe krimeve të tjera. Gjatë asaj kohe janë raportuar vetëm 1 rast i korrupsionit dhe 4 raste të krimit të organizuar.⁶⁰ Vetëm këto dosje të vjetra kanë mjaftuar për të mbajtur Komponentën e Drejtësisë të EULEX-it të zënë gjatë vitit 2009 duke lënë shumë pak hapësirë për procesim të shpejtë

⁵⁹ PK-ja ka zhvilluar përshkrime pune për menaxhmentin e vet të lartë dhe strukturës së re të policisë që janë miratuar dhe nënshkruar nga Ministri i Punëve të Brendshme pasi që gradimet e brendshme ndodhën. Ibid.

⁶⁰ Shih fq. 51 të Raportit Vjetor të Gjykatësve të EULEX 2009, në <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual->

dhe hetime të reja. Gjatë vitit 2010 misioni ka shtyrë përrpara hetimet në korrupsion dhe krim të organizuar.

Niveli i korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë është i paqartë dhe shpesh mbështetet nga thashethemet në mungesë të informatave lidhur me hetimet, paditë dhe vendimet.⁶¹ Për më tepër, raportohet se korrupsioni është shumë i përhapur në fusha të ndryshme në Kosovë dhe mbetet një brengë serioze për proceset e shtet-ndërtimit të Kosovës. Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2010 thekson disa nga këto mangësi duke konkluduar se deklarimi i fundëm i pasurisë së zyrtarëve të lartë në Kosovë ka treguar "...mospërputhje mes të hyrave dhe pronave të zyrtarëve të lartë të Kosovës. *Kjo sugjeron se korrupsioni i nivelit të lartë në Kosovë vazhdon të jetë i njëjtë.*"⁶² Grupet kryesore të interesit të intervistuar nga KIPRED mendojnë se përpjekjet e deritashme anti-korrupsion kanë qenë minimale si në synime ashtu edhe në rezultate. Ekziston përshtypja që zyrtarët e lartë apo bashkëpunorët e tyre kanë qenë imun ndaj hetimeve dhe përndjekjeve. Siç u shpreh një Prokuror Special:

"...[K]osova ka pasur shumë raportime në media për keqpërdorim të sistemit të prokurimit publik, sidomos të tenderëve...Është krijuar një gjendje e tenderomanisë ...hetime që i kemi parë në lidhje me këtë kanë qenë minimale, ne vetëm kemi parë disa peshqi të vegjël që janë hetuar dhe dënuar në mënyrë që të përmbushet norma..."

Raporte tjera ndërkombëtare në mënyrë të vazhdueshme kanë vënë në pah mangësitë që rrjedhin nga korniza politike, legjislative dhe institucionale e cila ka nevojë të forcohet më mirë me strukturat shumë-anëshe të cilat kërkojnë mekanizmat më të mirë koordinimi dhe komunikimi.⁶³ Mungesa e vullnetit politik për tu marrë me korrupsionin dhe krimin e organizuar, apo edhe ndërhyrjet politike në strukturat që merren me korrupsion janë brengosëse.

V. ZHVILLIMET E FUNDME NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Në nëntor të vitit 2009 Misioni për Sundim të Ligjit EULEX ngushtoi fokusin e vet për tu marrë kryesisht me raste të korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke shpallur

⁶¹ Raporti HR i Departamentit Shtetëror të SHB 2008

⁶² Më lart tek fusnota 46, fq.12.

⁶³ Shih "Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pas-Pavarësisë" ICG, Korrik 2010.

gjuetinë e vet për “peshqit e mëdhenj”, pas gati 10 vite të mosndëshkimit të rasteve të hetuara dhe përndjekura të krimit të organizuar.⁶⁴ Duke kaluar nga fjalë në vepra, me 28 prill të vitit 2010, misioni bastisi zyret e Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit të Kosovës (MTPT).⁶⁵ Aksionet erdhën në të njëjtën kohë kur EULEX-i po kritikohej për shkak se kishte filluar të përshtatej me realitetin kosovar, në vend se të sillte rezultate konkrete në luftimin e korrupsionit.⁶⁶ Këto bastisje spektakulare, të bëra nga policë të EULEX-it e armatosur deri në dhëmbë, ishin kryer vetëm nga EULEX-i, pa kurrfarë përfshirje të përfaqësuesve të prokurorisë lokale. Prokurori Shtetëror i Kosovës ka thënë për KIPRED se kur kishte filluar hulumtimi me 28 prill 2010 ai kishte pranuar një telefonatë nga Kryeprokurori në Detyrë i EULEX-it përmes të cilës ai e kishte informuar se do të fillonte hetimi në lokacionet e MTPT-së. EULEX-i ka arsyetuar këtë qasje të hershme të këtij operacioni të pavarur me sensitivitetin e rastit në fjalë.

Aksionet e EULEX-it u pasuan me ndjenja dhe deklarata të ndryshme të zyrtarëve të Kosovës. Deklaratat e para nga Kryeministri dhe Kryetari i Parlamentit të Kosovës bënë të dukej sikur qeveria po hapte një front të ri konflikti me EULEX-in dhe ICO-në për përfshirjen e zyrtarëve të lartë në hetime. Sidoqoftë, pas gati një muaj nodhi një ndryshim i papritur në diskursin politik të qeverisë së Kosovës dhe dega e vet legjislative kaloi nëpër ca ndryshime. Kryeministri i Kosovës deklaroi përkrahjen e tij të plotë për hetimet e EULEX-it dhe se ai personalisht ishte duke e udhëhequr luftën kundër korrupsionit në Kosovë.⁶⁷ Ministri i hetuar nuk dha dorëheqje dhe as nuk iu kërkua të jpte, por mu përkundrazi, zyrtarët e partisë politike që udhëheqte me qeverinë deklaruan krijimin e një fondi për mbrojtjen e Ministrisë ndër hetim, që u konfirmua nga zyrtarë të lartë partiak.⁶⁸ Për më tepër, ministrat apo bashkëpunorët të cilët janë nën hetim janë vendosur edhe në

⁶⁴ Me 3 nëntor 2009, në një intervistë me Kohën Ditore, Kryeprokurori i EULEX Theo Jacobs deklaroi se misioni ishte duke kërkuar “peshqit e mëdhenj” dhe se rezultatet do të tregoheshin në pranverën e vitit 2010. Intervista mund të gjehet në <http://www.koha.net/index.php?cid=1,7,17622>.

⁶⁵ Lokacionet private të Ministrisë të atëhershëm Limaj, të familjes dhe bashkëpunorëve të tij po ashtu u bastisën. EULEX-i deklaroi se Ministri Limaj dhe Kryesuesi i Furnizimit, Nexhat Krasniqi, mund të ballafaqoheshin me 55 vjet burg, nëse do të shpallehin fajtor nën akuzën për korrupsion. Intervistë me Kryeprokurorin në Detyrë të EULEX Johannes van Vresswijk në <http://www.balkaninsight.com/en/main/news/27936>.

⁶⁶ Letër e 14 OJQve kosovare drejtuar Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë Sigurie Lady Catherine Ashton, në lidhje me sundimin e ligjit në Kosovë <http://kipred.net/ëeb/eng.php?cid=2,10&id=23>

⁶⁷ Ky ndryshim erdhi si rezultat i bindjes nga misionet diplomatike në Kosovë. Për shembull për dy ditë me radhë pas bastisjes, një numër i takimesh u mbajtën duke përfshirë takimin e Qeverisë së Kosovës dhe një takim i Kryeministrit Thaçi me diplomatët ndërkombëtarë në Kosovë duke përfshirë Ambasadorin e SHBA Chris Dell dhe Ministrin Limaj. “Takim i jashtëzakonshëm i Qeverisë dhe PDK-së” *Koha.net* [KS], prill 28, 2010, (<http://www.koha.net/index.php?cid=1,7,19712&sq=limaj>)

⁶⁸ Anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe deputet i parlamentit Z. Nait Hasani, “PDK-ja krijon fonde për mbrojtjen e Limaj”, *Koha.net* [KS], prill 28, 2010 <http://www.koha.net/index.php?cid=1,22,23043&sq=limaj>

listën e partisë politike për zgjedhjet e jashtëzakonshme të 12 dhjetorit 2010. Kjo është parë si lëvizje e partive për të siguruar imunitet moral nga publiku.⁶⁹

Duke kaluar prej fjalëve në vepra Kryeministri i Kosovës vendosi të krijojë Task Forcën Anti-Korrupsion brenda Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës në mënyrë që të udhëheqë me hetimin dhe luftimin e trendeve të korrupsionit në Kosovë. Ndryshe prej kësaj, Raporti Programor për 2010 i EULEX-it pohon se Task Forca ishte krijuar brenda Zyrës së Prokurorisë Speciale në Kosovës (ZPSK) në datën e njëjtë kur ishte lëshuar vendimi i Kryeministrit, më 26 shkurt 2010⁷⁰ Megjithatë, Task Forca Anti-Korrupsion e themeluar së fundmi brenda Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës (ZPSK) është krijuar me përfshirjen minimale të konsultimeve me shërbimet shtetërore të prokurorisë së Kosovës.⁷¹ Task Forca ka 30 hetues policorë dhe 10 prokurorë specialë. Hetuesit policorë u janë deleguar Task Forcës nga Drejtorisë së PK për Krime Ekonomike dhe Korrupsion. Raporti i Progresit i KE-së për 2010 e sheh Drejtorinë si të ndikuar nga ndërhyrjet politike në kryerjen e hetimeve.

Garantimi i pavarësisë së hetimeve që do t'i ndërmarrë Task Forca do të mbesë një sfidë. Në hetimet fillestare të inicuar nga Task Forca, informatat mbi hetimet e papërfunduara rrodhën tek mediat.⁷² Me strukturat në dispozicion profesionalizmi dhe puna e pavarur e prokurorëve dhe hetuesve policorë do të vazhdojë të ballafaqohet me sfida në garantimin e hetimeve dhe përndjekjeve efikase duke përfshirë këtu edhe rastet e ndjeshme të zyrtarëve të lartë të dyshuar për sjellje korruptive.

Ngadalë Task Forca tejkaloi vështirësitë e para në koordinimin në mes të EULEX-it, Policisë së Kosovës dhe ZPSK-së. Roli i saj u bë më i qartë hap pas hapi me anë të përkrahjes së hetuesve të Policisë së Kosovës, prokurorëve të ZPSK-së nga pjesa ndërkombëtare e prokurorisë në Task Forcë. Një hetim i përbashkët me institucionet e Kosovës ka çuar drejt akuzimit dhe arrestimit të Guvernatorit të Bankës së Kosovës. Pasi që pavarësia e Task Forcës është rrezikuar nga vendimi i lëshuar nga Kryeministri, i cili është marrë me konsultimin minimal të prokurorisë shtetërore të Kosovës, termat e

⁶⁹ Intervistë e KIPRED me ish diplomatit Ballkanik, ekspert të shoqërisë civile, nëntor 2010.

⁷⁰ Vendimi 02/110, miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe i nënshkruar nga Kryeministri Hashim Thaçi më 26 shkurt 2010. Për dallim, Raporti Programatik i EULEXit në 2010 deklaroi se Task Forca brenda ZPSK është krijuar nga ZPSK në të njëjtën datë që është lëshuar vendimi i Kryeministrit, pra më 26 shkurt 2010. Raporti Programatik i EULEXit 2010, fq.43.

⁷¹ Intervistë e KIPRED me Prokurorin Shtetëror të Kosovës dhe Kryesuesin e KGJK, qershor dhe shtator 2010.

⁷² Intervistë e KIPRED me Prokurorin Special, qershor 2010.

referencës dhe struktura e Task Forcës duhet të rishikohen menjëherë pasi që të jetë funksionalizuar Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Për më tepër, KIPRED ka vërejtur se kushtet për themelimin e Task Forcës janë respektuar vetëm pjesërisht. Qeveria ka hezitur t'i japë mbështetje financiare apo çfarëdo mbështetje tjetër kësaj task force për gati tetë muaj pas themelimit të saj. Prokurorët specialë vazhdojnë të përballen me sfida të natyrës logjistike për shkak të mungesës së automjeteve adekuate për realizimin e hetimeve.⁷³ Mbrojtja fizike, që do të garantonte hetim të pavarur dhe autonom në krime serioze të korrupsionit, mund të bëhet vetëm prej rasti në rast. Stimulimi financiar i ndarë për prokurorë specialë, i paraparë me vendimin e qeverisë të marrë me 26 shkurt 2010, nuk u është dhënë.

Për më tepër, Raporti i Progresit për Kosovën për 2010⁷⁴ kritikon mungesën e hetimeve të pasurive të deklaruara të zyrtarëve të lartë pasi që u paraqitën shpërputhen midis të hyrave dhe pasurive të tyre. Kjo deri më tash nuk është hetuar nga Task Forca gjë që tregon një mungesë të vullnetit të strukturave ekzistuese të hetojnë korrupsionin, posaçërisht në raste që përfshijnë zyrtarët e lartë.

Gjatë periudhës 2009-2010 misioni i EULEX-it ka marrë vendime për 3 raste të krimit të organizuar dhe për 4 raste të korrupsionit.⁷⁵ Pritjet kane qenë gjithnjë e më të mëdha nga gjuetia e “peshqive të mëdhenj” e shpallur nga misioni po të cilat deri më tash kanë dhënë rezultate minimale. Guvernatori i Bankës së Kosovës është paditur për keqpërdorim të pozicionit zyrtar duke përfshirë akuza për shpërlarje parash, mito, tregtim me ndikim dhe shmangie taksash.⁷⁶ Sa i përket hetimit të Ministrisë së Transportit, një administrator i IT-së është akuzuar për shkatërrim dëshmishë. Akuzat e shumë pritura të zyrtarëve të lartë aktualisht nën hetime pritet që të ndodhin në të ardhmen.

EULEX-i duhet të adaptojë strukturën momentale dhe trendet operationale me mandatin e saj. KIPRED është i brengosur që nëse ndiqet trendi aktual ky mision mund të bëhet vetëm edhe një mision ndërkombëtar para-shpenzues i financuar nga taksapaguesit e shteteve antare të BE-së. Për më tepër, edhe pse përgjegjësia primare u bie

⁷³ Intervistë e KIPRED me prokurorin special të Task Forcës Anti-Korrupsion, korrik 2010.

⁷⁴ Ibid.

⁷⁵ Komunikim me email në mes të KIPRED dhe zyrës së Kryeprokurorit të EULEX, tetor 2010.

⁷⁶ Sajti zyrtar i EULEX.

institucioneve të Kosovës, do të jetë vështirë t'u kërkohej atyre përgjegjësi për shkak të kompetencave ekzekutive që i përdorë misioni i sundimit të ligjit EULEX. Strukturat dhe operacionet aktuale duhet të japin rezultate duke ngritur padi ndaj “peshqëve të mëdhenj” dhe duke hartuar një strategji dalëse pasi që të jenë ngritur disa padi dhe të jenë bërë disa gjykime për raste të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Misioni duhet ngadalë të ristrukturohet që të veprojë vetëm në komponentën MMK duke reduktuar kompetencat e saja ekzekutive. KIPRED mendon se kjo do të rrisë nivelin e llogaridhënies së drejtpërdrejtë ndaj institucioneve të Kosovës në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ngase ata pastaj duhet të tregojnë llogaridhënie para qytetarëve të Kosovës dhe të dëshmojnë vullnetin politik për të zbatuar sundimin e ligjit në Kosovë.

a) **Konfiskimi i dobive pasurore të fituara nga aktivitetet penale**

Pasuritëe fituara nga aktivitetet kriminale nuk mund të mbahen dhe do të konfiskohen.⁷⁷ Paratë apo prona që është e fituar përmes veprave kriminale sipas ligjit të zbatueshëm kosovar mund të konfiskohet ose përmes një vendimi gjyqësor që vërteton kryerjen e veprës penale ose me kërkesë të prokurorit publik para një paneli.⁷⁸ Policia dhe autoritetet tjera po ashtu mund të marrin pjesë në hetimin e rrethanave që mund të determinojnë përfitimet nga krimi i kryer.⁷⁹ Paratë ose prona që është dhënë, pranuar ose përfituar përmes kryerjes së një akti kriminal, për shembull pranimi i paarsyetuar i dhuratave, marrja apo dhënia e mitos dhe tregtimi me ndikim me vendimmarrje të një personi zyrtar, gjithashtu duhet të konfiskohen.⁸⁰ Nëse përfitimet nga akti kriminal u transferohen kushërinjëve të afërt, edhe ato duhet të konfiskohen.

Këto masa nuk janë përdorur në asnjërin nga rastet nën hetim apo në gjyq nga gjyqësia lokale e as ajo e EULEX. Prokurorët thonë se gjykatësit ngurrojnë t'i zbatojnë këto masa për shkak të kërcënimeve të mundshme të sigurisë që mund tu ndodhin dhe për shkak të mungesës së interesimit, përderisa gjyqtarët thonë se prokurorët nuk ua propozojnë këto masa mu për arsye të ngjashme.⁸¹ Mungesa e një ligji të veçantë mbi konfiskimin e pronës

⁷⁷ Kodi Penal i Kosovës, KREU VII për Konfiskimin e Dobisë Pasurore Siguruar nga Realizimi i Veprave Penale dhe arsye për Konfiskimin e Dobisë Pasurore, Neni 82, paragrafi 1 dhe 2.

⁷⁸ Kodi i Procedurave Penale i Kosovës, Neni 498.

⁷⁹ Ibid, Neni 499, paragrafi 3.

⁸⁰ Neni 83 i Kodit Penal të Kosovës.

⁸¹ Intervistë e KIPRED me prokurorin special dhe kreun e KGJK, korrik dhe shtator 2010.

së kriminelëve shpesh është përmendur si arsye për hezitim të gjyqeve të zbatojnë masa të tilla, edhe pse ekzistojnë dispozita të mjaftueshme ligjore. Ministria e Drejtësisë momentalisht është duke punuar në përplimin e një ligji të veçantë dhe ka krijuar një strukturë organizative për agjencinë që do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e aseteve të konfiskuara dhe të sekuestruara nga veprat penale.⁸² Sidoqoftë, agjencia tek pritet të bëhet funksionale.

Në këtë frymë, kapacitetet e gjyqeve dhe të prokurorive do të duhet të fuqizohen që të punojnë në konfiskimin e pasurive të kriminelëve të gjykuar, apo të kriminelëve të akuzuar në momentin që hetimi dhe përndjekja e rasteve të korrupsionit fillon. Kjo duket se nuk është praktikuar deri tash nga institucionet kosovare apo misioni i EULEX-it. Konfiskimi i dobive pasurore të fituara nga kryerja e veprave penale duhet të shihet si një masë ndëshkuese për të siguruar që pasuritë e përfituara nga kryerja e akteve kriminale nuk do të përdoren kundër interesave financiare të shtetit të Kosovës, por edhe si masë parandaluese në mënyrë që të mos lihen këto përfitime në duart e kriminelëve për të kryer krime të tjera. Konfiskimi i përfitimeve pasurore po ashtu jep një mesazh të qartë personave që përfitojnë nga krimi se krimi nuk do të shpaguehet.

VI. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nga viti 1999 e tutje Kosova vazhdon të jetë një vend tranzit, destinacion dhe burimor për trafikim me me qenie njerëzore (TIP).⁸³ Kodi Penal i Kosovës urdhëron sanksione më të larta për persona që kryejnë trafikim me qenie njerëzore dhe organizim të grupeve kriminale duke caktuar dënime që variojnë prej dënimeve në shume prej 500.000 eurosh deri në burgim prej shtatë deri në njëzet vjet. Si një nga tregtitë më fitimprurëse, së bashku me trafikimin e armëve dhe të drogës,⁸⁴ interesat e saj financiare janë të gjëra dhe as Kosova nuk është përjashtim.⁸⁵ Kosova kryesisht shihet si një vend ku trafikimi me qenie njerëzore ka pasë si shënjestër në veçanti gratë dhe vajzat për qëllime të eksploatimit seksual.

⁸² Raporti i Progresit 2010, fq 56.

⁸³ Kosova është raportuar për Trafikim me Persona të grave dhe vajzave për qëllim të eksploatimit seksual dhe punës së fëmijëve. Shih Raportin Global të Departamentit të Shtetit të SHB mbi Trafikimin me Persona, 2010 në...

⁸⁴ Shih për shembull uebfaqen e UNODC në...

⁸⁵ Në 2008, Departamenti i Shtetit të SHB raportoi se ekzistonin evidenca anekdotale në relacionet financiare dhe fisnore mes disa liderëve politikë dhe rrjeteve të krimit të organizuar në trafikimin e personave në Kosovë. Shih Raporti për Praktikën e Drejtave të Njeriut 2008, nga Byroja për Demokraci, Drejtë të Njeriut dhe Punë në Departamentin e Shtetit të SHB, 2009

Luftës kundër celulave trafikuese të krimit të organizuar, konfiskimit të pasurive të fituara nga këto vepra kriminale dhe kompensimit për viktimat e trafikimit u është kushtuar vëmendje minimale.⁸⁶ Kosova ka miratuar një numër të politikave, mekanizmave mbrojtës dhe garancioneve ligjore si reagim ndaj fenomenit të trafikimit. Sidoqoftë, reagimet kanë qenë më tepër reaktive se sa proaktive. Edhe pse Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Luftuar Trafikimin në Kosovë (2008-2011) do të duhej të përfundonte së shpejti, ajo ka dhënë rezultate të pakta. Në mënyrë që të parandolohet dhe zhdukjet kjo formë e krimit të organizuar, autoritetet e Kosovës duhet të shpejtojnë luftën kundër trafikimit përmes përndjekjes agresive të rrjeteve të organizuara kriminale. Hetimet dhe përndjekjet agresive si dhe dënime më të larta nga prokuroria dhe gjyqësia lokale shihen si forma të parandalimit dhe zhdukjes së krimit të TIP.⁸⁷ Për më tepër, hetimet ndërkombëtare dhe rajonale kundër krimit të organizuar mbeten të vogla.⁸⁸ Shërbimet lokale prokuroriale dhe gjyqësore duken se hezitojnë të kryejnë hetime, përndjekje dhe dënime adekuate për trafikuesit.

OJQ-të e grave vazhdojnë të japin shifra alarmuese mbi nivelin e trafikimit të grave dhe vajzave në Kosovë. Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit në Prishtinë (PVPT) ka strehuar 19 viktima të trafikimit gjatë viti 2009 dhe ka ndihmuar 32 viktima të tjera të mundshme në qendrën e vet të kujdesit ditor, që tregon një rritje të vogël në krahasim me shifrat e vitit 2008. Duke qenë që identifikimi i viktimave të trafikimit mbetet një sfidë, shifrat reale janë shumë më të mëdha.

Rezultatet në përndjekjen e celulave të trafikimit të krimit të organizuar mbesin të vogla. Për shembull, gjatë vitit 2009 vetëm 4 raste të trafikimit janë dënuar me pak më shumë se pesë vite burgim përderisa nga numri i përgjithshëm prej 22 trafikuesve të dënuar vetëm dy kanë filluar të kryejnë dënimin e tyre të burgimit ndërsa të tjerët kanë mbetur të lirë pas apelimit.⁸⁹ Për më tepër, sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore, misioni i EULEX-it i qaset këtij krimi vetëm si kompetencë suplementare e siç parashihet me Ligjin mbi Zyrën e Prokurorisë Speciale.⁹⁰ Sidoqoftë, në rastet kur ka dyshim të arsyeshëm apo fakte që tregojnë drejt një rasti të krimit të organizuar, Kreu i ZPSK-së mund të ushtrojë

⁸⁶ Ibid.

⁸⁷ Raporti Global mbi Trafikimin me Persona nga Departamenti i Shtetit të SHB, 2010

⁸⁸ Shih për shembull raportin programatik të 2009 nga EULEX- misioni i sundimit të ligjit në Kosovë.

⁸⁹ Më lart tek fusnota 21.

⁹⁰ Në pajtim me Nenin 9.1. paragrafi (f) të Ligjit mbi ZPSK-në.

kompetenca ekskluzive në pajtim me ligjin për ZPSK-në.⁹¹ Ndonëse ka vepruar kështu në rastet e fundme të trafikimit me organe në Kosovë, Kreu i ZPSK-së ka ngurruar të veprojë proaktivisht në hetimin e rasteve që përfshijnë trafikimin e grave dhe vajzave për qëllim të eksploatimit seksual.

Faktor tjetër që kanë kontribuar në numrin e vogël të përndjekjeve agresive të rasteve të krimit të trafikimit për qëllim të eksploatimit seksual është edhe kapaciteti i ulët i policisë së Kosovës në mbajtje të rendit të bazuar në informata inteligjence, me anë të të cilave aktivisht identifikohen strategji të përdorura nga rrjetet e krimit të organizuar. Për shembull, në të kaluarën policisë ju kanë nevojitur disa muaj për të reaguar ndaj strategjisë së ndryshuar nga trafikuesit, të cilët ndryshuan lokacionin e mbajtjes së viktimave nga hotelet dhe baret në shtëpia private.⁹² Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010, Policia e Kosovës ishte më pak efektive në paraqitjen e rasteve në Prokurori duke paraqitur vetëm 22 raste gjatë kësaj periudhe, derisa në 2009 gjatë të njëjtës periudhë të vitit policia ka bërë 373 bastisje, prej të cilave i vetëm 7 ishin shtëpia private. Metodatat klasike të bastisjeve të bareve nuk janë duke dhënë rezultate të mjaftueshme në hetimin dhe zbulimin e rrjeteve të krimit të organizuar duke qenë që trafikuesit vazhdimisht ndryshojnë metodatat e trafikimit.

Për më tepër, ekzistimi i një programi të mbrojtjes së dëshmitarëve për viktimat e trafikimit do të inkurajonte viktimat të bashkëpunonin me autoritetet dhe po ashtu do të mundësonte hetimin e lidhjeve të dyshuara në mes të celulave të trafikimit të krimit të organizuar. Mungesa e një ligji të veçantë për mbrojtjen e dëshmitarëve e pamundëson që deklaratat e dëshmitarëve të jenë të liruara nga çfarëdo ndërhyrje e jashtme apo nga frika e pasojave të mundshme. Vazhdon të mungojnë një mbajtje e rendit të udhëhequr nga informatat e inteligjencës dhe aksione të përbashkëta të policisë së Kosovës dhe misionit të EULEX-it në hetimin dhe përndjekjen e rasteve të trafikimit të grave dhe vajzave. Mungesa e gatishmërisë së gjykatësve dhe prokurorëve të Kosovës për të vepruar proaktivisht në përndjekjen dhe dënimin adekuat të celulave trafikuese të krimit të organizuar është brengë serioze.

⁹¹ Nën-pika n) te paragrafi 1 i Nenit 5, në Ligjin për ZPSK-në.

⁹² Intervistë e KIPRED me dhënësin e strehimit.

VII. TË GJETURAT KRYESORE

Sistemi i drejtësisë në Kosovë vazhdon të dëmtohet nga dobësitë strukturore, dhe të jetë i brishtë për shkak të ndërhyrjeve politike dhe problemeve të tjera. Më shumë se 200.000 raste civile dhe penale mbesin të pazgjidhura. Sistemi i kontrollimit dhe balancimit është i dobët, ngase dega qeverisëse shpesh ndërhyr në iniciativat e degës legislative dhe në institucionet e gjyqësorit. Gjatë tërë vitit 2010 dominoi debati për korrupsion në diskutimet publike në shoqërinë e Kosovës. Mungesa e historisë së punës në përndjekjen dhe dënimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit vazhdoi gjatë tërë vitit 2010.

Ekzistojnë thashetheme mbi nivelin e korrupsionit në Kosovë. Debatet janë nxitur deri në një masë edhe nga deklaratat dhe hetimet e misionit të EULEX-it, më saktësisht nga gjuetia për “peshqit e mëdhenj” që aludon në përfshirjen e njerëzve të profilit të lartë në aktivitete korruptive. Përderisa ky mision ka vazhduar të përpëlitet në mes të mandatit të vet politik dhe atij teknik, Raporti i Progresit për Kosovën i Komisionit Evropian ripohoi se vazhdon korrupsioni i në nivelet e larta. Përpjekjet për të eliminuar përfshirjen e elitës politike në jetën ekonomike dhe hetimet e sjelljeve korruptive të zyrtarëve të lartë kanë qenë përgjithësisht të dobëta.

Përkundër ekzistencës së mekanizmave dhe strategjive kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, vullneti politik për të përkrahur implementimin efektiv mbetet i dobët. Agjencia Anti-Korrupsion nuk ka arritur të kryej hetimet administrative lidhur me shpërputhjet në mes të deklaratave të pasurisë së zyrtarëve publikë dhe të të hyrave të tyre reale. Deri më tani nuk është vërejtur një vazhdimësi në hetimet dhe përndjekjet nga policia dhe shërbimet prokuroriale. Sanksionimet për sjelljet korruptive të parapara me ligj janë të dobëta ngase dënimet janë vetëm të natyrës administrative dhe duhet që të ndryshohen që të konsiderohen si shkelje penale. Kjo kontribuon në mungesën e mekanizmave anti-korrupsion në llogaridhënien e zyrtarëve për veprimet e tyre, pasi që hetimet administrative dhe prokuroriale prekin njëra-tjetrën pa ndonjë ndarje të qartë të përgjegjësisë dhe mandateve. Për shkak të dispozitave të dobëta ligjore dhe ndërthurjes së mandatave, dyshimi i përfshirjes së stafit administrativ dhe politik në sjellje korruptive do të vazhdojë.

Përkundër faktit se sundimi i ligjit mbetet një prioritet për perspektivën evropiane të Kosovës dhe që lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar shihen si dobësia më e madhe në përpjekjet për të krijuar dhe mirëmbajtur një sundim efektiv të ligjit në Kosovë, autoritetet investuan vetëm 1,5 % të buxhetit në gjyqësinë e Kosovës. Kjo ndarje e buxhetit është minimale kur krahasohet me 17 përqindshin e buxhetit të investuar në investime kapitale infrastrukturore të udhëhequra nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, e cila momentalisht është nën hetime nga misioni i EULEX-it për keqpërdorim të buxhetit të Kosovës.

Pritjet shoqërore për një luftë të suksesshme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë rritur, sidomos pas bastisjeve spektakulare dhe inicimit të hetimeve nga EULEX-i. Sidoqoftë, rezultatet në këtë aspekt kanë qenë minimale. Deri në tetor 2010, misioni i EULEX-it ka rezultuar me dënime vetëm në 3 raste të krimit të organizuar dhe në 4 raste të korrupsionit.

Pavarësia e Task Forcës Kundër Korrupsionit, e cila gjendet përbrenda ZPSK-së, është rrezikuar nga vendimet e Kryeministrit, të cilat i ka marrë pas konsultimeve minimale me shërbimet të prokurorisë lokale. Përbërja e tanishme e sajë mund të jetë dobësuar për shkak të ndikimeve politike pasi që emërimi i hetuesve policorë është bërë nga Drejtoria për Krim të Organizuar dhe Korrupsion, hetimet e të cilës bazuar në Raportin e Progresit të BE për vitin 2010 duket se u janë nënshtruar ndërhyrjeve politike.

Kosovës vazhdojnë t'i mungojë një legjislacion për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe marrëveshjet për bashkëpunim rajonal për mbrojtje të dëshmitarëve të përfshirë në raste të krimit të organizuar dhe korrupsionit trans-nacional. Konfiskimi i pasurive të fituara nga veprat kriminale, duke përfshirë korrupsionin e nivelit të lartë, nuk është realizuar në asnjë nga rastet e hetuara apo të përndjekura nga institucionet e Kosovës apo misioni i EULEX-it.

Kosova arriti të miratojë një numër të ligjeve të rëndësishme që po e pengonin pavarësinë dhe autonominë e shërbimeve gjyqësore dhe prokuroriale. Ligjet po ashtu filluan reformën e thellë gjyqësore të Kosovës. Ligji për Gjykata, Ligji për Prokurorinë Shtetërore, Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës u miratuan gati tri vite pasi që ato ishin paraparë në Kushtetutën e Kosovës.

Ligji për Gjykatat ka krijuar kushtet për reformim të thellë strukturor të sistemit gjyqësor edhe pse strukturat e reja të gjykatave do të fillojnë të implementohen në 2013. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka vazhduar të punojë në menaxhimin e shërbimeve gjyqësore dhe prokuroriale duke qenë që Këshilli Prokurorial i Kosovës ende s'është futur në funksion.

Reforma gjyqësore do të fillojë pjesërisht në janar të vitit 2011. Kjo përfshin pagesa më të larta financiare për gjykatësit dhe prokurorët, duke i barazuar pagat e tyre me ato të degës ekzekutive. Rritja e pagave do të ndikojë drejtpërsëdrejti në situatën e gjykatësve dhe prokurorëve. Megjithatë, në 2011 do të duhen të bëhen aranzhime të nevojshme që qeveria të mund të caktojë burime të mjaftueshme buxhetore për të implementuar këto reforma.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe trupi i tij autonom, Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, vazhduan procesin e verifikimit dhe riemërimit të gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë. Procesi i verifikimit dhe riemërimit përfundoi zyrtarisht në fund të tetorit 2010. Megjithatë, procesi nuk do të zgjidhë problemin e numrit të pamjaftueshëm të gjykatësve dhe prokurorëve në gjykatat e Kosovës. Kosova do të vazhdojë të ketë rreth 3 deri në 5 gjykatës e prokurorë më pak në krahasim me vendet në rajon, siç janë Serbia, Mali i Zi apo Kroacia. KGJK-ja do të duhet të vlerësojë strategjikisht kapacitetet e gjyqësisë së Kosovës dhe të dalë më një propozim dhe planifikim të buxhetit për mbështetjen e sistemit gjyqësor të Kosovës që do e garantonte efikasitetin e punës. Deri në tetor të vitit 2010, KGJK-ja dështoi të veprojë në lidhje me çështje strategjike siç janë akumulimi i rasteve të papërfunduara, punësimi i personelit, dhe nevojat për buxhet dhe trajnime për gjykatësit dhe prokurorët. Qeveria e ardhshme e Kosovës, që do të formohet pas zgjedhjeve të përgjithshme të 12 dhjetorit 2010, do të duhet të përkrahë plotësisht strategjitë e KGJK-së dhe KPK-së për burime njerëzore dhe buxhetore që të mundësohet implementimi i reformës gjyqësore, që përfshin rritjen e numrit të gjykatësve dhe të prokurorëve.

Gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it vazhdojnë të kenë një mandat ekzekutiv në luftën kundër krimit të organizuar, krimeve të luftës dhe korrupsionit. Gjykimet kryesore që janë bërë deri tash nga gjykatësit e EULEX-it kanë qenë për raste të krimeve të luftës, të trashëguara nga administrata kaluar e UN-it. Hetimet proaktive të EULEX-it në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë qenë shumë të ngadalshme në nxjerrjen e

rezultateve. Misioni ka deklaruar hetimet e zyrtarëve të lartë si prioritet për vitet 2010 dhe 2011. Komponenta e drejtësisë në EULEX nuk ka burime të mjaftueshme duke qenë që ka vetëm 20 prokurorë dhe 30 gjykatës të shtrirë në tërë Kosovën. Me strukturën aktuale operacionale, EULEX-i do të ketë probleme në përmbushjen e mandatit të vet.

Gjykatësit dhe prokurorët vazhdojnë të punojnë nën një sistem të dobët të mbrojtjes, të bazuar në kërkesa për mbrojtje nga rasti në rast. Kjo ka çuar drejt një situatë ku gjykatësit dhe prokurorët, për shkak të ndërhyrjeve të jashtme apo edhe nga frika prej pasojave të mundshme, ngurrojnë të nisin raste të ndjeshme, në veçanti raste të krimeve të luftës, krimet të organizuar dhe korrupsionit. Sistemi gjyqësor vazhdon të varet nga mandati ekzekutiv i gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it. Në përgjithësi, vizioni për të fuqizuar pavarësinë e gjyqësorit dhe autonominë e shërbimeve prokuroriale duket se ka pasur pak sukses për shkak të reformave gjyqësore të nisura rishtazi. Sidoqoftë, këto procese kryesisht varen nga vullneti dhe mbështetja e donatorëve. Qeveria ka dështuar në dhënien e mbështetjes së mjaftueshme buxhetore për të rritur kapacitetet e shërbimeve gjyqësore dhe prokuroriale, duke treguar kështu një mungesë të vullnetit për të forcuar kornizën gjyqësore dhe pavarësinë e saj.

Agjenci tjera të zbatimit të ligjit, siç është Policia e Kosovës, janë përballur me mungesën e ekspertizës, pajisjeve dhe pavarësinë profesionale për të kryer hetime në rastet e krimet të organizuar dhe korrupsionit. Hetimi i trafikimit të qenieve njerëzore si pjesë e krimet të organizuar dhe korrupsioni i nivelit të lartë mbeten sfida. Ndryshimet e fundme në menaxhmentin e lartë të policisë, përgjegjëse për hetimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit dhe krimet të organizuar, do të vazhdojnë të ndikojnë në pavarësinë e hetimeve. Ka pasur mungesë të ristrukturimeve adekuate dhe gradimeve në bazë të performancës. Do të jetë shumë e vështirë që të arrihet barazpeshimi dhe garantimi i hetimeve të balancuara në rastet e korrupsionit që përfshijnë hetime në sjelljet korruptive të zyrtarëve të lartë. Kosova do të duhet të ri-vlerësojë strukturat e veta aktuale të zhvilluara për hetime administrative dhe prokuroriale, në mënyrë që të përforcojë rolin e KGJK-së dhe PK-së në luftën kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar. Sa i përket garantimit të një shteti të qëndrueshëm që bazohet në sundimin e ligjit, Kosova momentalisht qëndron në një udhëkryq. Lufta kundër krimet të organizuar dhe korrupsionit duhet të çlirohet nga ndërhyrjet politike.

VIII. REKOMANDIME

Shtetet anëtare të BE-së duhet të dyfishojnë numrin e gjykatësve dhe prokurorëve në misionin EULEX-it në mënyrë që të barazojnë funksionet ekzekutive me ato MMK të këtij misioni të ESDP-së. Kjo do të shërben si pjesë e strategjisë për të rritur edhe operacionet ekzekutive dhe tëMMK, në mënyrë që të vazhdohet me hetimin dhe përndjekjen e rasteve të profilit të lartë. Në të njëjtën kohë EULEX-i duhet tu mundësojë gjykatësve dhe prokurorëve kosovarë të vazhdojnë punën e tyre në mënyrë të pavarur kështu përderisa misioni harton një strategji dalëse për tërheqjen e fuqive të saja ekzekutive deri në fund të vitit 2012.

Shtetet anëtare të BE-së duhet të zvoglojnë rolin e policisë kundër trazirave dhe për kontrollin e turmave deri në fund të vitit 2011. Në të njëjtën kohë, shtetet e BE-së duhet të forcojnë rolin e policisë së specializuar në hetime të krimit të organizuar dhe korrupsionit duke rritur numrin e policëve të sjellur nga vendet me përvojë në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

EULEX-i duhet të japë rezultate të menjëhershme në përndjekjen e rasteve të korrupsionit politik. Kjo do të dërgonte një sinjal të fortë autoriteteve të posa zgjedhura dhe do rriste vullnetin e përgjithshëm politik të institucioneve të Kosovës në përkrahjen e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Zhvillimi i historisë së punës së padive dhe vendimeve në këto raste do të përkrahë Kosovën në përmirësimin e performancës së vet në sundim të ligjit që mos të shkojë në drejtim të shtetit të dështuar.

EULEX duhet të pëmbahet që të mos bëjë analizë të stabilitetit politik afat shkurtër dhe të mos lejojë influencim politik në punën e tyre kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Stabiliteti afat shkurtër do të ketë efekte afat gjata në shtetësinë e Kosovës. Kosova do të përfitonte nga mandati i misionit për sundimit të ligjit nëse do t'i përforconte mekanizmat e hetimit dhe përndjekjes proaktive duke përfshirë mekanizmat për mbajtjen e rendit të udhëzuar nga informatat e intelgjencës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të fitojë mbështetje adekuate buxhetore për të përmbushur mandatin e vet. Mbështetja e dhënë duhet të përfshijë hapësira adekuate të

zyreve, pagesa adekuate për gjykatës dhe strategji proaktive në definimin e prioriteteve të sistemit gjyqësor.

KGJK-ja duhet të rishikojë qasjen e vet aktuale dhe strukturat që ka në dispozicion në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kjo duhet të përfshijë zhvillimin e një strategjie, në vend të zbulimeve dhe rezultateve aktuale në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Strategjia do të duhej gjithashtu të merrte në konsiderim emërimin e gjykatësve që do t'i jepnin prioritet rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë ofrimin e mbrojtjes së veçantë për gjykatës. Iniciativa do të duhej të shkonte krah për krah me strategjinë për burime njerëzore e buxhetore të KGJ-së për të rritur numrin e gjykatësve në Kosovë bazuar në vlerësimet e tyre.

Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të bëhet operacional menjëherë, duke u siguruar burime adekuate njerëzore dhe buxhetore në mënyrë që të përmbushin mandatin e vet. Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet të vendosë në praktikë planifikimin autonom buxhetor të KPK-së në përputhje me dispozitat e ligjit të ri për KPK-në. Për më tepër, KPK do të duhej të revidojnë termat e referencës dhe pastaj në bazë të asaj të hartojnë termat e reja të referencës dhe strukturën e re për Task Forcën për Anti Korrupsion dhe pastaj ajo të bëhet funksionale.

Ministria e Drejtësisë duhet të vijojë menjëherë me miratimin e projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve. Miratimi i ligjit duhet të përfshijë edhe planifikim të detajuar për marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale për dëshmitarët bashkëpunues, duke garantuar burime të mjaftueshme buxhetore. Buxheti i mbledhur nga konfiskimi i pasurive të fituara përmes veprave kriminale duhet të shfrytëzohet si mbështetje financiare për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve.

Përdorimi i dispozitave ligjore për konfiskim të përfitimeve materiale nga aktivitetet kriminale duhet të fillojë menjëherë. Agjencia për Administrimin e Pasurive të Konfiskuara dhe të Sekuestruara duhet të bëhet operacional menjëherë. Emërimi i stafit të Agjencisë duhet të jetë i pavarur nga ndërhyrjet politike.

Bibliografia:

Kuvendi i Kosovës, 'Deklarata e Pavarësisë së Kosovës', shkurt 2008
Ligji nr.03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës
Ligji nr.03/L-053 për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë
Ligji nr.03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit
Ligji nr.03/L-151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik
Ligji nr.03/L-199 për Gjykatat
Ligji nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës
Ligji nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës
Ligji nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit
Ligji nr.2004/34 Kundër Korrupsionit
Ligji nr.03/L-155 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr.02/L-133 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik

Balkan Insight, nga Artan Haraqija, 'Jessen-Petersen: 'Unë jam ndaluar që të hetoj korrupsionin'', qershor 2010
nga Vjosa Musliu, 'Krizë Globale 'nxit' pavarësinë e Kosovës', mars 2009

Komisioni Evropian, 'Raporti i Progresit për Kosovën nën Rezolutën 1244/99', nëntor 2010

Këshilli i Evropës: Komiteti i Ministrave, 'Rekomandimi Rec(2000)19 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për Rolin e Prokurorisë Publike në Sistemin Gjyqësor Kriminal', tetor 2000

Këshilli i Bashkimit Evropian, 'Vendimi i Këshillit 2010/446/CFSP', gusht 2010
'Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP', shkurt 2008

EULEX, 'Raporti vjetor 2009 mbi Aktivitetet Gjyqësore të Gjyqtarëve të EULEX-it', 2010
'Raporti i Programit 2010', 2010
'Raporti i Programit 2009', korrik 2009

Forumi për Iniciativë Qytetare dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi, 'Sundimi i Ligjit: kapacitetet dhe funksionimi institucional', nëntor 2010

Grupi Ndërkombëtar i Krizave (GKN), 'Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pas-pavarësisë', korrik 2010

Korporata e Financave Ndërkombëtare dhe Banka Botërore, 'Bërja e biznesit: Matja e Rregulloreve të Biznesit', 2010

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED), nga Krenar Gashi, 'Trekëndëshi i Brishtë: Koordinimi i Policisë, Gjyqtarëve dhe Prokurorëve gjatë procedurës penale në Kosovë', shkurt 2010

Ministria e Drejtësisë, nga Sahit Shala dhe Nexhat Haziri, ‘Raporti i punës të Prokurorisë Publike në Republikën e Kosovës: 2009’, prill 2010
‘Raporti mbi Resurset Njerëzore të Prokurorisë Publike në Republikën e Kosovës – çereku i 2të për vitin 2010’, shtator 2010

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, ‘Të sigurohemi se shtetet e brishta nuk lihen prapa’, 2007
‘Shtet-ndërtimi në situata të brishtësisë’, gusht 2008

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, ‘Seksioni i Monitorimit të Sistemit të Drejtësisë Raporti Mujor – qershor 2009’, shtator 2009

Departamenti i Shtetit Amerikan, ‘Raporti për të Drejtat e Njeriut 2008: Kosova’, shkurt 2009
‘Deklaratë për Klimën e Investimeve 2009 – Kosova’, shkurt 2009
‘Raporti për Trafikimin e Personave’, qershor 2010

Kombet e Bashkuara, ‘Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës’, shkurt 2007

Kombet e Bashkuara Programi për Zhvillim, ‘Raporti i Paralajmërimit të hershëm’, përgjatë 2010

UNMIK, Kodi Penal i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25 e plotësuar dhe ndryshuar nga Kuvendi i Kosovës më 6 nëntor 2008
Kodi i Procedurës Penale, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 e plotësuar dhe ndryshuar nga Kuvendi i Kosovës më 6 nëntor 2008



Mbështetur nga: **K|C|S|F** 
Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
Kosovar Civil Society Foundation